



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E TE ARDHURAVE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2020

Lënda: Kthim përgjigje

Z. _____
Rr. _____

Në përgjigje të kërkesës suaj, rregjistruar në Bashkinë Shkodër me nr.14765 prot., dt.20.10.2020, në të cilën kërkon informacion mbi urdhër bllokimin e llogarisë suaj personale, ju sqarojmë se:

Kundrejt Bashkisë Shkodër jeni debitor në shumën 800.000 (tetëqindmijë) lekë, nga të cilat 500.000 (pesëqindmijë) lekë gjobë të vendosura nga IMT e Bashkisë Shkodër me vendim nr.372, datë 17.09.2018 si dhe 300.000 (treqindmijë) lekë kamatvonesa për mos pagesë të gjobës brenda afateve ligjore.

Me vendim nr.468, datë 14/10/2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Shkoder vendosi rrëzimin e kërkesë padisë suaj si të pa bazuar në prova dhe ligj, duke ngarkuar shërbimin përbarimor gjyqësor për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor.

Me shkresë nr.20107 prot., datë 20.11.2019 të Bashkisë Shkodër është njoftuar Zyra e Shërbimit Përbarimor Shtetëror, Shkodër me kërkesën për ekzekutimin e vendimit nr.372, datë 17.09.2018.

Me shkresën nr.159 dkp rregj 1872, datë 10.09.2020 të përbaruesit të Zyrës Përbarimore Shkodër, rregjistruar në Bashkinë Shkodër me nr.13147 prot, datë18.09.2020, është njoftuar IMT mbi vendimin e pezullimit të urdhërit të ekzekutimit nr.468, datë 10.10.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër.

Udhëri i bllokimit të llogarisë bankare është bërë, bazuar në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore ne R.SH", i ndryshuar, neni 90, pika 1, Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për taksat vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" si dhe paketës fiskakale të Bashkisë Shkodër.

Qëllimi i Bashkisë Shkodër, nuk është që tju sjellë dëm ekonomik apo moral, por që ju të paguani detyrimin që keni ndaj këtij institucioni për kundravajtjen që ju vetë keni bërë.

Në pamundësi likujduesen të shumës së plotë, mund ti drjtoheni Bashkisë Shkodër me kërkesën për shlyerje me këste të detyrimeve.

Bashkangjitur, do të keni faturen për detyrimin ndaj Bashkisë Shkodër

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

KRYETAR

Voltana ADEMI